

VENDIM
Nr. 3, datë 19.1.2015

PËR DISA PROJEKTE FITUESE PËR INFRASTRUKTURËN VENDORE
(THIRRJA E PESTË PËR VITIN 2014), SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR.17, DATË 19.11.2014, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, “PËR
SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR INFRASTRUKTURËN VENDORE, THIRRJA E
PESTË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr.160, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte të infrastrukturës vendore, në vlerën 270 800 000 (dyqind e shtatëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë, pjesë e thirrjes së pestë, shpallur në vendimin nr. 16, datë 10.10.2014, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhej vendimit nr. 17, datë 19.11.2014, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për infrastrukturën vendore, thirrja e pestë”, bëhen ndryshime sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Autoritetet kontraktuese, për projektet sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit deri në fillim të tremujorit të dytë të vitit 2015. Për fondet e projekteve të paprocuruara sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën për të rishqyrtuar financimin dhe rialokimin e fondeve të këtij financimi për një projekt tjetër.

4. Ngarkohet sekretariati teknik pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit të bëjë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve pranë Njesisë së Bashkërendimit të Programeve Zhvillimore dhe Planifikimit Strategjik, pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit të Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, sipas kalendarit të paraqitur nga NQV-të, në përputhje me pikën 3, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Anëtar;
Ministri i Financave	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	Anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar;
Ministri i Kulturës	Anëtar;
Ministri i Mjedisit	Anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	Anëtar;

Tabela 1. Projektet për financim të infrastrukturës vendore, thirrja e pestë

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Financimi 2015
Qarku Korçë				
1	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rehabilitimi i bregut të liqenit të Ohrit dhe gjelbërimi përgjatë rrugës segmenti Lin-Pogradec	198,895,706	141,011,968
Qarku Lezhë				
2	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtimi i këmbëve të urës në fshatin Skuraj, Milot	4,000,000	2,800,000
3	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Sistemim – asfaltim i rrugës së fshatit Malbardhë, Milot	40,000,000	28,000,000
4	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Hartimi i studimeve dhe projekt ideve për projekte komplekse urbane	100,000,000	100,000,000
TOTALI			342,895,706	270,800,000

Shënim:

1. “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën brenda të cilës caktohet fondi limit për prokurimin (kur nuk ka financim tjetër nga NJQV-të).
2. “Vlera e financimit” për vitin 2015 tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015.
3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2015, do të financohet nga FZHR për vitin 2016.
4. Detajimi i fondit për projektin 4 (Hartimi i studimeve dhe projekt ideve për projekte komplekse urbane) bëhet me vendim të Këshillit Drejtues të FSHZH
5. Për projektin me nr. 2, ndërtimi i pjesës së trupit të urës do të merret përsipër nga Ministria e Mbrojtjes.

Tabela 2. Ndryshim në tabelën 1, që i bashkëlidhej vendimit nr.17, datë 19.11.2014

Projektit nr.6 i ndryshon autoriteti kontraktues, si edhe vlerat e financimit (duke sjellë ndryshim të vlerës totale), si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë projektit (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2014 (lekë)
6	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Sistemim asfaltim Rruga nga Bashkia Vlore deri te Spitali	90,000,000	72,000,000

